



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:043452
Datë: 24.01.2025
Numri i dokumentit: 06755917

ARJ.nr.185/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Delushe Halimi kryetare, Ragip Namani dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “A. T.” Sh.p.k me seli në F. K., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Zyhdi Axhemi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit të paditurës nr.01.3.2.2/1400, të datës 24.02.2020, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1130/23, të datës 12.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23 janar 2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi “A. T.” Sh.p.k me seli në F. K., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1130/23, të datës 12.10.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1130/23, të datës 12.10.2023, është vendosur si në vijim: Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “A. T.” Sh.P.K me seli në F. K., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.131/23, të datës 10.07.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1130/23, të datës 12.10.2023, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e

bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.1130/23, të datës 12.10.2023, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.131/23, të datës 10.07.2023, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin nr.01.3.2.2/1400 të datës 24.02.2020, e paditura Dogana e Kosovës, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet kërkesa e subjektit në procedurë “A. T.” Sh.p.k me seli në F. K., për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore nr.1., 23.01.2020 i ZBD I., dhe R2., 06.01.2020 të ZBD Prishtinë, si të pabazuara, ndërsa mbetet në fuqi rivlerësimi i Sektorit të Pranimit Qendror për deklaratat e lartcekura. II. Aprovohet kërkesa e subjektit në procedurë për Deklaratën Unike Doganore R1., 17.01.2020 të ZBD I., dhe anulohet rivlerësimi i kësaj deklarate nga ana e Sektorit të Pranimit Qendrorë. III. Lejohet kthimi i mjeteve të paguara më tepër subjektit në procedurë, “A. T.” Sh.p.k – F. K., në xhirlogarinë nr.1..., të evidentuara pranë P. C. B.

Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Dogana e Kosovës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, KF.nr.131/23, të datës 10.07.2023, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet kërkesëpadija e paditësit “A. T.” Sh.P.K me seli në F. K. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Zyhdi Axhemi, si e pa bazuar. II. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.01.3.2.2/1400 i datës 24.02.2020 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Gjykata ka vlerësuar ligjshmërinë e aktit përfundimtar aktvendimit të Doganës së Kosovës të ankimuar nga paditësi si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, me të cilin aktvendim në procedurë administrative, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi edhe pse i ka prezantuar gjykatës provat materiale tjera si fatura dhe pro faturat e mallit, transaksionet bankare të P. C. B. të datës 31.12.2019 dhe 13.01.2020, kontratat e shitblerjes, mirëpo pala paditëse nuk ka anit të dëshmoj harmonizimin në mes të vlerës së faturës dhe vlerës së pro faturës në kuptim të shumës, pastaj vlerës së faturës në raport me transaksionet bankare ndërkombëtare, pastaj pagesa për mallin lëndor është bërë në emër të pro faturave dhe jo të faturave kontestuese siç kërkohet me nenin 33 të KDA-së, pastaj transaksioni bankar në përshkrimin e tij përmban numrin e secilës pro faturë

dhe jo numrin e faturës për mallin lëndor kontestues, dhe përkundër kësaj transaksionet bankare nuk përputhen në kuptim të shumave me faturat e DUD-ave kontestues, prandaj nga të gjitha këto, gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pa pranueshme për zbatim të nenit 33 të KDA-së, pasi që i njëjti është jo i harmonizuar dhe pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor që është transaksion bankar, të njëjtat nuk janë të harmonizuara në kuptim të vlerës, sasisë, referencës me faturë dhe vlerë të mallit sikurse në faturat nr.0.., 1.., 1.., 0.., Këtë fakt si të tillë e ka konfirmuar edhe ekspertiza financiare e datës 06.06.2023. Duke u bazuar në nenin 33 par. 1 të KDAK-së dhe nenin 34 par.1, gjykata ka konstatuar se e paditura në rastin konkret ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuar nga paditësi duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë siç parashihet me ligj pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar si dhe çmimin vërtet të paguar siç përcaktohet në nenin 33 par. 1 të KDAK-së. Prandaj edhe është dashur që të provoj saktë me prova materiale argumentet dhe pretendimet e tij në padi dhe ankesë pasi që paditësi në rastin konkret bartë detyrimin e vërtetimit të pretendimeve në padi ndërsa provat e paraqitura në gjykatë nuk janë me ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsytet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj ndër të tjera thekson se: Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin KF.nr.131/23, të datës 15.05.2023, ka caktuar ekspertizë financiare, në këtë kontekst tregtar administrativ me ekspertin financiare M. M., e cila ka pasur për detyrë të konstatoj diferencën e mjeteve të paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të DUD-ave kontestues R-1.., 23.01.2020, R-2.., 06.01.2020, për secilin DUD veç e veç dhe për të gjithë së bashku, diferencën e paraqitur veçmas për taksën doganore, veçmas për TVSH-në, harmonizimin e transaksioneve bankare ndërkombëtare në raport me faturat përcjellëse të mallit të DUD-ve kontestues në kuptim të vërtetimit të statusit të transaksionit bankar ndërkombëtar, harmonizimin e shumës së paguar me transaksionin bankar ndërkombëtar në raport me vlerën si në faturë/pro faturë, për DUD-at kontestues, përshkrimin e pagesës së bërë në transaksionet bankare

ndërkombëtare, në raport me numrat e faturave apo pro faturave sipas DUD-ve kontestues, harmonizimin e faturave përcjellëse të DUD-ave si më lartë të mallit në raport me pro faturat, kontratën dhe dokumentacionin përcjellës të mallit dhe fakte tjera të rëndësishme për vendosjen e kësaj çështje juridike administrative. Ekspertja financiare në ekspertizën financiare të datës 19.06.2023, ka konstatuar se vlera e pro faturave në USD për pagesë ka qenë 37, 125 X)USD ndërsa vlera e faturave në euro të paguar sipas transferit bankar të datës 31.12.2019 është 37,100.00 USD ku diferenca në mes të pagesës së realizuar dhe vlerës sipas pro faturave është 37, 125.00 USD që i bie se për 25.00 USD është më pak, dhe se në përshkrim të transaksionit bankar ndërkombëtar është përshkruar numri i pro faturës e jo i faturës. Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës duke vlerësuar se transaksionet e prezantuara nga paditësi të datës 31.12.2019 dhe 13.01.2020 nuk janë të harmonizuara as në kuptim të përshkrimit dhe as me vlerën e faturave përcjellëse të mallit faturat nr.0..., 1..., 1..., 0..., mirëpo të njëjtat në përshkrimin e tyre u referohen vetëm pro faturave, pro fatura këto që nuk përputhen me faturat si më lart as në kuptim të sasisë së mallit dhe as vlerës.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimi të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimi të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/1400, të datës 24.02.2020, me të cilin refuzohet kërkesa e subjektit në procedurë, "A. T." Sh.p.k me seli në F. K., për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore nr.1..., 23.01.2020 i

ZBD Interevropa dhe R2., 06.01.2020 të ZBD Prishtinë, si të pabazuara, ndërsa mbetet në fuqi rivlerësimi i Sektorit të Pranimit Qëndror, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimet e paditësit, të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, se nuk është zbatuar drejtë neni 231 i KDAK-së, lidhur me nenin 406 të UA 11/2009, si dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka ftuar në shqyrtim kryesor të çështjes ekspertin financiar, kolegji i Gjykatës Supreme, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoi në tërësi si të pabazuara, për arsye se paditësi në asnjë fazë të procedurës nuk ka kërkuar plotësim të ekspertizës apo sqarim lidhur me ekspertizën nga ana e ekspertit financiar, e këtë gjë nuk e ka kontestuar as në ankesën e ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, andaj fakti i mos prezencës së ekspertit në këtë çështje nuk e ndryshon gjendjen faktike ku edhe është pretendimi kryesorë i paditësit ashtu që edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi as pranë organit të administratës dhe as pranë gjykatës, nuk ka arritur që të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar me vendimin kontestues, dhe nga dëshmitë e parashtruara nuk mund të kundërshtohet as ekspertiza financiare e as vlera reale e mallit të zhdoganuar.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkelje të dispozitave të procedurës apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale, vlerësoj se këto pretendime janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, KDAK-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.185/2024, më datë 23 janar 2025

B. Profesionale
Zanë Buçinca

Kryetare e Kolegjit
Delushe Halimi